

VENDIM
Nr.994, datë 6.10.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.438, DATË 28.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË ZBATUESHËM, PËR TË KUALIFIKUAR OBJEKTET NË NDËRTIM, QË LEGALIZOHEN OSE JO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 pika 1, e 46, pika 1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.438, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 të kreut I, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Objekti i ndërtuar pa leje ose shtesa e sipërfaqes tej lejes së miratuar nuk kualifikohet për legalizim ose, nëse është kualifikuar, legalizimi ndërpritet në çdo kohë përpara lëshimit të lejes së legalizimit sipas nenit 28 të ligjit, në rast se legalizimi.”.

b) Shkonja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) shkel vijën e ndërtimit në rrugët e kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë, të parashikuar nga plani i përgjithshëm rregullues, studimet urbanistike apo projektet e veçanta infrastrukturore rrugore të çdo niveli, të miratuara a në proces;”.

c) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1”, me këtë përmbajtje:

“c/1. cenon zbatimin e projekteve për zona turistike, zona komerciale dhe rekreative, zonat ekonomike, parqe dhe impiante industriale, për të cilat ka studime të miratuara ose në proces;”.

ç) Në shkronjën “e” bëhen këto ndryshime e shtesa:

- Në fjalinë e parë, pas fjalëve “... kufirit mbrojtës ...” shtohen “... të zonës komerciale dhe rekreative, të zonave ekonomike apo ...”.

- Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) zonë turistike sipas përcaktimit të bërë në nenet 64, 65 e 66 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe të pikës 39 të nenit 4 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar.”.

- Pas nënndarjes “iii” shtohet nënndarja “iv”, me këtë përmbajtje:

“iv) zonë ekonomike sipas ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.”.

2. Pas shkronjës “c” të pikës 4 të kreut I, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) sipas rastit, në dokumentacionin e paraqitur nga organet shtetërore përgjegjëse, sipas pikës 8/1 të këtij vendimi.”.

3. Pas pikës 8 të kreut II, shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8.1 Kur objektet ndodhen në kushtet e moskualifikimit për legalizim, organet shtetërore përgjegjëse kanë të drejtë t’i kërkojnë ALUIZNI-t ndërprerjen e legalizimit, duke specifikuar dhe shkaku konkret sipas pikave 2 e 3 të këtij vendimi, për të cilin ALUIZNI është i detyruar të ndërpresë procesin. Kërkesës duhet t’i bashkëlidhet, detyrimisht, dokumentacioni provues. ALUIZNI është i detyruar, që, brenda 2 (dy) javëve nga data e depozitimit të kërkesës, t’u konfirmojë ndërprerjen e procedurave organit shtetëror përgjegjës dhe personit të interesuar për legalizimin e ndërtimit pa leje. Në rast se, me kalimin e këtij afati, ALUIZNI nuk ka konfirmuar ose ka refuzuar ndërprerjen e legalizimit, organi shtetëror përgjegjës ka të drejtë t’i kërkojë Këshillit të Ministrave pezullimin e procedurave të legalizimit të objekteve pa leje. Këshilli i Ministrave vendos sipas afateve dhe procedurës së përcaktuar në paragrafin e dytë të pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha